

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL I TURIZMIT
RAJONI I ALPEVE SHQIPTARE

RREGULLORE E PLANIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Z. BLENDI KLOSI

**PLANI I KOMBËTAR SEKTORIAL I TURIZMIT
PËR RAJONIN E ALPEVE SHQIPTARE**

RREGULLORE E PLANIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, Datë 09.12.2017

STUDIO KONSULENTE

PM Group, *Irlandë*.

Instituti i Politikave Publike dhe Private IP3,
Tiranë.



PËRMBAJTJA

KREU 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	4
Neni 1. Objekti	4
Neni 2. Qëllimi	4
Neni 3. Përkufizimet	4
Neni 4. Shtrirja e PKST-së	5
Neni 5. Detyrimi për zbatim i kësaj rregulloreje	6
Neni 6. Rregullore të tjera të detyrueshme për zbatim në zonë	6
Neni 7. Bordi i monitorimit të zbatimit të PKST-së	6
KREU 2. DISPOZITA PËR TË GJITHË ZONËN NË STUDIM	7
Neni 8. Zonat e kufizimit të Zhvillimit	7
Neni 9. Rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe të ruajtjes së peizazhit	7
Neni 10. Lloji i produktit turistik	8
Neni 11. Turizmi specifik në lokalitete	9
Neni 12. Funksionet dhe aktivitetet e propozuara sipas llojit të produktit turistik	9
Neni 13. Elemente që duhen trajtuar nga plane të tjera PKS, PPV PSV etj	10
Neni 14. Orientime për infrastrukturën rrugore në zonë	10
Neni 15. Aksesimi në zonë dhe itineraret	11
Neni 16. Transporti publik turistik	11
Neni 17. Orientime për pika dhe akse panoramike (itinerare)	12
Neni 18. Orientime për sinjalistikën e shtigjeve	12
Neni 19. Orientime mbi administrimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të përdorur	14
Neni 20. Orientime mbi trajtimin e vijave të ujit	14
Neni 21. Orientime mbi trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane	14
Neni 22. Orientime mbi shërbimin e telekomunikacionit	14
Neni 23. Orientime mbi energjinë dhe burimet alternative	14
Neni 24. Orientime për trajtimin arkitektonik të strukturave	14
Neni 25. Orientime për llojet e strukturave akomoduese	15
Neni 26. Orientime për struktura të veçanta	16
KREU 3. DISPOZITA TË VEÇANTA PËR LOKALITETE	16
Neni 27. Klasifikimi i lokaliteteve	16
Neni 28. Lokalitetet dhe rrezja e influencës	16
Neni 29. Kapaciteti akomodues optimal	17
Neni 30. Lokalitetet e nivelit 1 - Koplik	18
Neni 31. Lokalitetet e nivelit 1 - Bajram Curri	20
Neni 32. Lokalitetet e nivelit 2 - Vermosh	23
Neni 33. Lokalitetet e nivelit 2 - Tamarë – Selcë	26
Neni 34. Lokalitetet e nivelit 2 - Razëm	29
Neni 35. Lokalitetet e nivelit 2 - Reç	32
Neni 36. Lokalitetet e nivelit 2 - Bogë	35
Neni 37. Lokalitetet e nivelit 2 - Lugina e Kirit	38
Neni 38. Lokalitetet e nivelit 2 - Nënnavriq	40
Neni 39. Lokalitetet e nivelit 2 - Koman	43
Neni 40. Lokalitetet e nivelit 2 - Dushaj	45
Neni 41. Lokalitetet e nivelit 2 - Valbonë	46
Neni 42. Lokalitetet e nivelit 2 - Lekbibaj	49
Neni 43. Lokalitetet e nivelit 2 - Tropojë e vjetër	52
Neni 44. Lokalitetet e nivelit 3 - Lëpushë	55



Neni 45.	Lokalitetet e nivelit 3 - Vukël	58
Neni 46.	Lokalitetet e nivelit 3 - Theth	61
Neni 47.	Lokalitetet e nivelit 3 - Curraj i Epërm	64
Neni 48.	Lokalitetet e nivelit 3 - Çerem	67
Neni 49.	Lokalitetet e nivelit 3 - Rragam	70
Neni 50.	Lokalitetet e nivelit 4 - Sulbicë	72
Neni 51.	Lokalitetet e nivelit 4 - Blini i Gurit të Lekës, lumi i Shalës	74
KREU 4. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT		76
Neni 52.	Shtrirja e rregullores	76
Neni 53.	Ndryshimet e rregullores	76
Neni 54.	Hyrja në fuqi	76



KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Rregullorja e PKST-Alpe ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe kushteve të zbatueshme në lidhje me zhvillimin e sektorit të turizmit dhe rregulla të zbatuara në nivele të tjera planifikimi, si p.sh., planet sektoriale në nivel qarku, planet e përgjithshme vendore dhe vendore sektoriale që garantojnë zbatimin e PKS-së dhe mbrojtjen e territorit, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 2 Qëllimi

1. Qëllimi i Rregullores është që nëpërmjet përcaktimit të rregullave të saj, të orientojë drejtimet kryesore të zhvillimit për Rajonin e Alpeve Shqiptare në sektorin e turizmit duke shmangur efektet negative të zhvillimit spontan dhe të pakontrolluar të zonës.
2. Qëllimi i këtyre rregullave është të mbështesin zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor, që garanton qëndrueshmërinë për brezat e ardhshëm në territorin e Alpeve Shqiptare, në përputhje me orientimet e PPK-së dhe Strategjisë Kombëtare të Turizmit.
3. Rregullorja mbështetet në parimet e zhvillimit të një turizmi i cili respekton, mbron dhe promovon në mënyrë të qëndrueshme vlerat e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe sociale të një territori, për të minimizuar ndikimin negativ që mund të shkaktojë turizmi në zonë.
4. Këto rregulla synojnë të mbështesin rritjen e prodhueshmërisë dhe përfitimit ekonomik të zonës së Alpeve Shqiptare, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e zhvillimit ekonomik dhe social të gjithë popullsisë lokale, mbështetur në ruajtjen e vlerave afatgjata të aseteve mjedisore.
5. Rregullorja orienton zhvillimet territoriale për të ndërhyrë në mënyra të padëmshme për mjedisin, duke respektuar, mbrojtur dhe përmirësuar ekspozimin e vlerave kulturore materiale e jomateriale dhe vlerave peizazhiste.
6. Rregullorja dhe PKST synojnë shmangien e

zhvillimeve që ndikojnë mbi natyrën e virgjër, peizazhin, arkitekturën karakteristike, dhe dëmtojnë, kufizojnë ose ulin vlerat, avantazhet dhe përftimet ekonomike potenciale.

7. Rregullorja dhe PKST synojnë krijimin e një mjedisi të sigurt dhe me standarde që minimizon riskun natyror dhe mbështet shëndetin publik.
8. Rregullorja synon të ulë informalitetin dhe të lehtësojë zhvillimin e konkurrencës së drejtë e të lirë, për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Neni 3 Përkufizimet

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Bujtinë” (shtëpi pritëse)** - është një ndërtesë ku banon pronari i saj, i cili vë në dispozicion të turistëve një pjesë të hapësirave të brendshme për të ofruar akomodim dhe ushqim përkundërt pagesës.
2. **“Fjetina” (Hostel)** - është një strukturë ku ofrohet akomodim dhe/ose ushqim për turistët, në të cilat dhoma ndahet mes disa klientëve të ndryshëm.
3. **“Fjetje dhe mëngjes” (B&B)** - është strukturë turistike akomoduese që ofron shërbimin e fjetjes dhe mëngjesit, në të cilën nuk ofrohen shërbim restoranti dhe ambiente të përbashkëta për turistët.
4. **“Hotel”** - strukturë akomodimi turistik, me jo më pak se 6 dhoma, ku ofrohet akomodim, ushqim, pije, etj., dhe ka një staf të specializuar dhe të kualifikuar.
5. **“Hotel i shpërndarë”** - integrimi në një sistem unitar menaxhimi i disa banesave ekzistuese tradicionale, të vendosura në një fshat ose lokalitet turistik me karakter autentik për të siguruar strehim, qëndrim dhe integrim të pushuesit në stilin e jetesës së komunitetit pritës, duke ofruar ambiente shërbimi të përbashkëta, falë një stafi të specializuar dhe të kualifikuar.
6. **Itinerar turistik** - është një trajektore turistike e strukturuar, tematike ose e përgjithshme, në të cilën ofrohen produkte të ndryshme të industrisë së turizmit, duke përfshirë informacionin turistik, transportin, qëndrimin dhe



- akomodimin.
7. **"Kamping"** - zonë publike ose private, ku turistët mund të akomodohen në tenda kampingu ose në mjete motorike akomoduese (kamper), duke përfutur shërbimet bazë si: ujë, tualete, energji elektrike etj.
 8. **"Kapacitet akomodues turistik optimal"** - përcakton kapacitetet akomoduese të një destinacioni turistik pa transformuar në mënyrë të dëmshme këtë të fundit. Ky kapacitet përcaktohet si numri i shtretërve të ofruar nga strukturat akomoduese tregtare, që nuk cënon në mënyrë të ndjeshme karakteristikat mjedisore, sociale, ekonomike dhe kulturore të destinacionit turistik.
 9. **"Lokalitete turistike"** - janë vendbanime, fshatra dhe/ose grupime banesash, ku për shkak të vlerave peizazhistike, arkitektonike dhe historike, ka potencial për mikpritjen e vizitorëve.
 10. **"Motel"** - është strukturë turistike akomoduese që ofron shërbim akomodimi dhe parkimi për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve, me vendndodhje kryesisht në periferi të qendrave të banuara.
 11. **"Pika vrojtimi e peizazhistike"** - Vende në kuota të larta, ku ofrohen pamje panoramike të natyrës së zonës, monumente natyrore apo vendbanime dhe monumente të trashëgimisë kulturore dhe historike, të pajisura me infrastrukturë dhe arredim urban.
 12. **"Qendër kurative"** - është strukturë turistike akomoduese që shërben për terapitë kurative, e pozicionuar në zona me vlera natyrore dhe terapeutike, me një staf të specializuar dhe të kualifikuar.
 13. **"Rrezja e influencës"** - Hapësira territoriale ku ndodh ndërveprimi turistik i menjëhershëm i çdo lokaliteti.
 14. **"Resort"** - është një grup ndërtesash të administruara së bashku që i ofron turistëve akomodim, ushqim, pije dhe/ose veprimtari sportive dhe argëtuese, nëpërmjet një stafi të specializuar dhe kualifikuar duke ruajtur karakterin, kulturën dhe traditën e zonës.
 15. **"Strehim alpin"** - struktura private ose publike strehimi, të vendosura në zona të paaksesueshme malore, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë strehim dhe ndoshta ushqim për alpinistët ose udhëtarët. Këto struktura kryejnë një funksion me interes publik të lidhur me sigurinë, si për shembull: ofrimi i shërbimeve të informacionit mbi itineraret, lidhja me shërbimet e emergjencës civile, strehimi i personave që përballen me ndryshime meteorologjike të paparashikuara ose rreziqe të tjera natyrore dhe ofrimi i ndihmës së parë. Administrimi, funksionimi dhe detyrat e strehimeve alpine do të realizohen në bazë të një rregulloreje të posaçme.
 16. **"Struktura për sporte dimri - ski"** - Përcaktohen si zona për sporte dimërore skish të gjitha sipërfaqet me borë natyrore dhe artificiale me përdorim publik që përfshijnë pista, parqe bore, impiante ngjitjeje dhe krijimi bore, përfshirë të gjitha strukturat e nevojshme ajrore e nëntokësore dhe shërbimet mbështetëse që janë të rezervuara për praktikimin e sporteve dimërore në borë të të gjitha formave: ski, snowboard, slita, ski nordike dhe sporte të tjera të lidhura me borën.
 17. **"Struktura të lehta, të përkohshme"** - Këto struktura duhet të jenë: i) të çmontueshme (që çmontohen dhe montohen pa dëmtuar materialet përbërëse); ii) të ndërtruara pa themele dhe me dysheme të shkëputur nga toka; dhe iii) nuk duhen ndërtruara në bazamente betoni të përherëshëm apo në themele të ngjashme.
 18. **"Shtëpi / banesë me qira"** - është një ndërtesë ose banesë e cila vihet në dispozicion të turistëve përkundrejt pagesës.

Neni 4

Shtrirja e PKST-së

1. Zona në studim shtrihet në territorin administrativ të qarkut Shkodër e Kukës dhe përfshin pjesërisht territoret administrative të bashkive Vau i Dejës (Temal, Shllak), Shkodër (Pult, Shalë, Shosh), Malësi e Madhe (Kelmend, Shkrel), Tropojë (Bajram Curri, Lekbibaj, Margegaj, Bujan, Tropojë e Vjetër).
2. Zona e planifikimit të PKST-së zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 2,003 km², me një gjatësi maksimale prej 64 km dhe një gjerësi maksimale prej 60 km, duke përbërë gati 6.9% të territorit shqiptar, duke mbuluar të gjithë zonën e Alpeve Shqiptare, në të cilën përfshihen luginat e dhjetë lumenjve kryesorë (nga veriperëndimi në lindje): Vermoshit, Çemit, Vuklit, Përroit të Thatë ("Lumi i Thatë"), Kirit (ose Kir), Shalës, Curraj i Epërm, Nikaj-Mërturit, Drinit (përf-



shirë këtu liqenin artificial të Komanit deri në Fierzë), Valbonës, Gashit dhe Lumit të Tropojës.

3. Zona e planifikimit të PKST-së përfshin këto zona të mbrojtura natyrore:
 - a. Rezerva Strikte Natyrore / Rezervat Shkençor "Lugina e Lumit të Gashit", Kategoria I e mbrojtjes
 - b. Parku Kombëtar "Lugina e Valbonës", Kategoria e II e mbrojtjes
 - c. Parku Kombëtar "Theth", Kategoria e II e mbrojtjes
 - ç. Parku Kombëtar i Alpeve Shqiptare - (proces miratimi)
 - d. Parku Natyror Bashkiak "Nikaj-Mërtur", Kategoria e IV e mbrojtjes
 - dh. Parku Natyror Bashkiak "Shkrel", Kategoria e IV e mbrojtjes

Neni 5

Detyrimi për zbatim i kësaj rregulloreje

1. Zhvillimi i turizmit në mënyrë të qëndrueshme në rajonin e Alpeve Shqiptare arrihet nëpërmjet integritit të:
 - a. gamës së plotë të sektorëve ekonomikë e socialë, të çështjeve sociale dhe mjedisore;
 - b. përgjegjësi të qarta ligjore dhe rregullatore nga nivelet e ndryshme të qeverisjes kombëtare, rajonale dhe vendore;
 - c. planifikimit të territorit dhe shtrirjes në kohë të ndërhyrjeve (strategji afatgjata dhe investime të menjëhershme);
 - ç. njohurive, përvojës dhe interesave të grupeve të interesit, organizatave jofitimprurëse dhe publikut të gjerë.
2. Kjo rregullore zbatohet nga:
 - a. institucione publike: ministritë, agjencitë e menaxhimit rajonal dhe bashkitë;
 - b. komuniteti;
 - c. subjekte fizike dhe juridike;
 - ç. organizata jofitimprurëse;
 - d. organizata, donatorë vendas dhe të huaj, etj

Neni 6

Rregullore të tjera të detyrueshme për zbatim në zonë

1. Në funksion të zbatimit më të mirë të Planit Kombëtar Sektorial të Turizmit duhet të

respektohen parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar me ndikim në sektorin e turizmit dhe në funksion të rritjes ekonomike të vendit nëpërmjet politikave që zbusin zhvillimin e pabarabartë rajonal, forcojnë partneritetin strategjik me vendet fqinje, forcojnë konkurrencën e sektorëve ekonomikë për të garantuar në këtë mënyrë integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

2. Në funksion të zbatimit të PKST-së duhet të respektohen edhe detyrimet e përcaktuara në kuadrin ligjor për parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura duke siguruar mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës si elemente të rëndësishme të zhvillimit të turizmit.
3. Subjektet zbatuese të këtij plani duhet të kenë në konsideratë edhe bashkërendimin e politikave për zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga plane të tjera sektoriale kombëtare.
4. Duhet të respektohen gjithashtu edhe detyrimet planifikuese dhe zhvilluese të parashikuara nga Planet e Përgjithshme Vendore për çdo bashki, pjesë e zonës së planifikimit sektorial të PKST-së.

Neni 7

Bordi i monitorimit të zbatimit të PKST-së:

1. Ky plan menaxhohet nga një bord, i cili ka detyrë monitorimin e zbatimit të këtij plani në përputhje me rregullat e kësaj rregulloreje dhe kuadrin ligjor në fuqi.
2. Bordi përbehet nga përfaqësues të ministrisë së linjës për turizmin, autoritete vendore: qarqet dhe bashkitë, si dhe profesionistë dhe organizata të fushave me ndikim në sektorët e turizmit.
3. Funksionimi i Bordit rregullohet me rregullore të veçantë.



KREU 2 DISPOZITA PËR TË GJITHË ZONËN NË STUDIM

Neni 8

Zonat e kufizimit të zhvillimit

- 1. Distanca nga brigjet dhe vijat e ujit:** Të gjitha ndërtimet duhet të ruajnë distancat minimale nga liqenet, rezervuarët dhe vijat e ujit (lumenj, përrenj, kanale, etj.) sipas legjislacionit në fuqi, pavarësisht krijimit apo jo të brezave mbrojtës nga hartat e planit. Në rast mospërputhjeje, distanca më e madhe është detyruese. Në territorin midis vijës së ujit dhe vijës së tërheqjes (vija blu) lejohen dhe promovohen ndërhyrje mirëmbajtjeje për të përmirësuar funksionet hidrike dhe vlerat ekologjike.
- 2. Kufizimi i ndërtimit në shpatet e pjerrëta:** Kufizohen zhvillimet në të gjitha tokat me një pjerrësi më të madhe se 30%. Për vepra të veçanta lejohen zhvillimet duke respektuar normat e sigurisë sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor. Në zonat të cilat konsiderohen të prirura në mënyrë të veçantë ndaj erozionit, njësitë e qeverisjes vendore mund ta zgjerojnë zonën e identifikuar për mbrojtje pas një studimi gjeologjik, në mënyrë që të përfshijnë shpatet me pjerrësi më të ulët.
- 3. Kufizimi i ndërhyrjeve në afërsi të monumenteve të natyrës:** Në zonat e evidentuara si monumente natyrore nuk mund të kryhen ndërhyrje në një distancë minimale prej 100 m. Bashkitë mund të vendosin kufizime më të mëdha në Planin e Peizazhit.
- 4. Kufizimi në zonat e monumenteve të kulturës:** Çdo ndërhyrje në objektet monument kulture do të bëhet sipas legjislacionit të posaçëm. Të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore kanë një zonë kufizuese prej 100 m, nëse në legjislacionin përkatës nuk është përcaktuar ndryshe.
- 5. Në rast mbivendosjeje të zonave kufizuese, atëherë gjithnjë do të mbizotërojnë rregullat kufizuese më të rrepta.**

Neni 9

Rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe të ruajtjes së peizazhit

- 1. Krahas zonave mbrojtëse të burimeve ujore, për**

monumentet e natyrës në zonë aplikohen rregullat e planeve të menaxhimit të parqeve.

- 2. Asetet e peizazhit mund të përdoren në kohën e lirë dhe për argëtim aktiv pa ndryshuar përdorimin e përcaktuar nga Planet e Menaxhimit të Parqeve, nga ky plan dhe PPV-të.**
- 3. Zonat e ruajtjes së peizazhit përfshijnë:**
 - a. Kreshtat dhe majat e maleve
 - b. Luginat e lumenjve dhe grykat e maleve me shpate të pjerrëta
 - c. Liqenet alpine dhe zonat natyrore përreth
 - ç. Zonat pyjore dhe pyjet e mbrojtura
 - d. Ekosistemet dhe habitatet natyrore
 - dh. Zonat e prekshme nga erozioni
 - e. Gjeomonumentet – në këto zona aplikohen programe të posaçme që synojnë:
 - Krijimin e mundësive të vizitave të gjeomonumenteve
 - Ruajtjen dhe identifikimin e çdo territori ku nuk lejohet prania e njeriut
 - ë. Peizazhe bujqësore-kulturore të mbrojtura (parcelizimi, kulturat bujqësore tradicionale, rrethimet tradicionale etj).
 - f. Fshatrat tradicionale: në tipologjinë arkitektonike dhe në tipologjinë hapësinore. Në këto lokalitete mund të aplikohen distanca sigurie deri në 500 m për zhvillimet e reja më synim ruajtjen e tipologjisë hapësinore dhe arkitektonike.
 - g. Monumentet e trashëgimisë kulturore dhe historike: duhet të jenë pjesë e programeve të mirëmbajtjes periodike dhe të vlerësohen nëse mund të hapen për vizitorët duke u kthyer në atraksione turistike. Zonat përreth tyre në një distancë 500 m duhet të trajtohen me programe të veçanta rikualifikimi urban. Çdo ndërhyrje në fashën 500 m duhet të marrë në konsideratë udhëzimet e organeve kompetente për këto struktura (Instituti i Monumenteve).
 - gj. Në pikat e vrojtimit në këto vendndodhje, krahas pajisjes me infrastrukturë dhe ardim urban, qeverisja vendore mund të lejojë dhe tregtarë ambulantë.
- 4. Në kuotat mbi 1700 m nuk lejohen ndërtime të asnjë lloji përveç strehimeve alpine, tendave të alpinistëve apo strukturave të staneve.**
- 5. Strukturat për sporte dimri do të lejohen në të gjithë zonën bazuar në një studim fizibiliteti dhe ruajtjeje të peizazhit. Përcaktimi i rregullave specifike si dhe miratimi i tyre do të jetë**



kompetencë e KKT-së.

6. Përveç zonave të parqeve dhe zonave të mbrojtjes së peizazhit, planeve sektoriale, PPV-ve dhe bordit monitorues, gjatë zbatimit të këtij plani mund të përcaktohen zona të tjera me vlera peizazhistike për ruajtje.

Neni 10

Lloji i produktit turistik

1. **Turizmi natyror:** i referohet turistëve që duan të eksplorojnë një shumëllojshmëri burimesh natyrore, duke përjetuar një eksperiencë ose aventura të pasura, lidhur me natyrën dhe traditën lokale.
 - a. Turizmi i qëndrueshëm / ekoturizmi / turizmi ekologjik: është i orientuar drejt ekosistemeve, biodiversitetit, ekologjisë. Turistët shfaqin një interes për edukimin dhe sensibilizimin ndaj problematikave mjedisore, duke praktikuar aktivitete që tentojnë të ruajnë ekuilibrin mes mjedisit dhe turizmit.
 - b. Turizmi malor dhe hapësirave natyrore: i referohet turistëve që nëpërmjet një eksperiencë aktive duan të eksplorojnë peizazhe dhe masive malore me vlera të larta natyrore dhe peizazhistike.
 - c. Turizmi i parqeve dhe zonave të mbrojtura: është i orientuar drejt vizitave të parqeve natyrore dhe zonave të mbrojtura me biodiversitet të lartë.
 - ç. Turizmi ujqor: është i orientuar drejt eksperiencës dhe aktiviteteve të praktikuara në liqene, lumenj, përrenj etj.
2. **Turizmi kulturor:** i referohet turistëve të interesuar në trashëgiminë kulturore të prekshme dhe të paprekshme të një territori. Këta janë turistët që kërkojnë të zgjerojnë horizontin e tyre intelektual falë kulturës, traditës, njohjes me stilin e jetesës, folklorit, festave kulturore lokale etj.
 - a. Turizmi i historisë dhe kulturës lokale i referohet turizmit të interesuar në historinë, traditën, monumentet e kulturës, vlerat arkitektonike, folklorin dhe rregullat sociale.
 - b. Turizmi industrial dhe artizanal i referohet turizmit të interesuar në kulturën prodhuese të së shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes, karakteristikat ose specifikat e zonës si artizanati dhe industria (aktivitet prodhuese: uzina, fabrika, ateliere, miniera, hidrocentrale, etj).
- c. Turizmi fetar dhe i objekteve të kultit i referohet turizmit të interesuar në përmirësimin e gjendjes morale apo shpirtërore të vizitorëve.
- ç. Turizmi shkencor është i orientuar drejt shkencës, pedagogjisë dhe kërkimit në fusha të ndryshme të shkencës dhe natyrës. Këta janë turistë të cilët kërkojnë të zgjerojnë horizontin e tyre intelektual në fushën e shkencave ekzakte dhe ato të natyrës.
- d. Turizmi krijues është një turizëm i organizuar rreth aktiviteteve krijuese, bashkëpunuese dhe edukative. Këta janë turistë të cilët kërkojnë të angazhohen me mësimin e traditave lokale, valleve dhe veglave muzikore, artizanatin lokal, gatimet, etj.
3. **Turizmi rural:** Formë turizmi e praktikuar në ambiente rurale, duke theksuar cilësinë e jetës në fshat dhe produktet vendore.
 - a. Agroturizmi / turizmi i fermave bujqësore është një formë e turizmit objekt i të cilit është eksplorimi i prodhimit bujqësor dhe blegtoral të një zone, i ndërthurur me vlerat peizazhistike, traditën dhe karakterin rural.
 - b. Turizmi i gastronomisë dhe i produkteve lokale i referohet turizmit të interesuar në specialitetet gastronomike, produktet ushqimore dhe pijet lokale.
4. Turizmi i aventurës dhe sportit: i referohet turistëve të interesuar në aktivitete argëtuese, rekreative dhe sportive.
 - a. Turizmi argëtues dhe rekreativ i referohet turizmit që bazohet në nevojat për aventura dhe adrenalinë.
 - i. Turizmi argëtues / rekreativ i “butë”, ku turistët kërkojnë një nivel të moderuar të përfshirjes fizike.
 - ii. Turizmi argëtues / rekreativ “aktiv”, ku turistët kërkojnë një nivel të lartë përfshirjeje fizike, ku faktori rrezik i përgjigjet sfidës fizike personale.
 - b. Turizmi i aeronautikës: parashutizëm / paragliding / sky-diving / parapent
 - c. Turizmi i çiklizmit është i orientuar drejt eksperiencës dhe aktiviteteve të lidhura me çiklizmin.
 - ç. Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit është i orientuar drejt eksperiencës dhe aktiviteteve të ecjes, marshimit apo ngjitjeve në shpate malore me nivele të ndryshme vështirësie.
 - d. Turizmi i speleologjisë i referohet turizmit të



interesuar në vizitat dhe eksplorimin e shpellave.

5. **Turizmi urban:** i referohet turizmit që mbështetet në nevojat urbane.
 - a. Turizmi i eventeve bazohet në evente të organizuara në një zonë të caktuar.
 - b. Turizmi shëndetësor i referohet turizmit për qëllime shëndetësore dhe kurative, duke pasur për fokus shëndetin e vizitorëve dhe aktivitetet kurative.
 - c. Turizmi i biznesit ose profesional i referohet turizmit që orientohet drejt aktiviteteve që lidhen ngushtë me formimin profesional ose kulturën e sipërmarrjes.
 - ç. Turizmi social dhe i solidaritetit orientohet drejt një turizmi i cili mbështet popullsinë lokale në nevojë dhe mundëson aktivitete turistike për popullsinë me të ardhura të ulëta.

Neni 11

Turizmi specifik në lokalitete

Në zonën e Alpeve Shqiptare mbizotëron një turizëm i orientuar drejt natyrës, aventurës, kulturës lokale dhe eksplorimit të monumenteve natyrore. Cilësia e peizazhit natyror, mikpritja, stili i jetesës, mundësia për të takuar popullsinë lokale, gastronomia, ecja në natyrë dhe në mal, janë avantazhet konkurruese kryesore të identifikuar nga vizitorët e Alpeve Shqiptare.

Për një shfrytëzim optimal të potencialit turistik të një lokaliteti, specifikimi i produkteve turistike për çdo lokalitet lehtëson lidhjen e avantazheve konkurruese të lokalitetit me segmentet turistike potenciale, shërben si orientues për aktivitetet turistike që do të ofrohen në zonë dhe orienton specializimin e lokaliteteve drejt një oferte turistike konkurruese.

Llojet e produkteve turistike të një lokaliteti specifikohen në dy kategori:

- **Turizmi kryesor:** që nënkupton llojet e produkteve turistike që lidhen ngushtë me avantazhet konkurruese të lokalitetit dhe përbëjnë arsyen kryesore për të vizituar zonën.
- **Turizmi mbështetës:** që nënkupton llojet e produkteve turistike që mbështesin produktet turistike kryesore dhe përbëjnë një interes në garantimin e qëndrueshmërisë së aktivitetit turistik të territorit.

Neni 12

Funksionet dhe aktivitetet e propozuara sipas llojit të produktit turistik

1. **Turizmi natyror**

- a. Turizmi i qëndrueshëm / ekoturizmi / turizmi ekologjik: vizita në zona me biodiversitet të lartë, ekosisteme të ndryshme, rezervate natyrore, peizazhe dhe parqe natyrore, studim i florës dhe faunës, kurse dhe aktivitete sensibilizuese për problematikat mjedisore, për ruajtjen e biodiversitetin dhe speciet në zhdukje.
- b. Turizmi malor dhe i hapësirave natyrore: shëtitje në natyrë dhe shtigje panoramike (në këmbë, kuaj dhe mushkë), vizita në monumente të natyrës (gjeomonumente, ujëvara, kanione, pyje, lumenj, përrenj, shpella, korridore të gjelbra), piknikë, shëtitje me ski, ski nordike, ecje me raketa dhe slita.
- c. Turizmi i parqeve dhe zonave të mbrojtura: vizita në zona të mbrojtura, rezervate natyrore dhe monumente të natyrës.
- ç. Turizmi ujqor: vizita në brigje dhe gjire natyrore me vlera peisazhistike, gjeomonumente ujore, aktivitete ujore: peshkim, kanoa, kajak, not, canyoning, waterballs, rafting.

2. **Turizmi kulturor**

- a. Turizmi i historisë dhe kulturës lokale: vizita në muze, monumente të kulturës, site arkeologjike, kulla historike, fshatra historike me vlera arkitektonike, pika interesi turistike përfaqësuese të stilit të jetesës, vende historike dhe legjendare, galeri arti, njohje me zakonet dhe rregullat sociale të zonës, me folklorin dhe legjendat lokale, kurse kërcimi të valleve popullore dhe të veglave muzikore lokale, udhëtime në itinerare kulturore, etj.
- b. Turizmi industrial dhe artizanal: vizita në atelierët e artizanatit, hidrocentrale dhe mullinj, kurse për prodhimin dhe mundësi blerjeje të produkteve të artizanatit.
- c. Turizmi fetar dhe i objekteve të kultit: vizita dhe pelegrinazh në monumentet e kultit e vendet e shenjta dhe pjesëmarrje në ceremonitë fetare.
- ç. Turizmi shkencor: studim i florës dhe faunës, specieve të mbrojtura ose në zhdukje, eksplorim i etnografisë, arkitekturës lokale dhe astronomisë.
- d. Turizmi krijues: atelier kuzhine, qëndisjeje,



poçerie, pikturë, vizatimi dhe skulpturë.

3. Turizmi rural

- a. Agroturizmi / turizmi i fermave bujqësore: vizita në ferma bujqësore, blegtorale dhe baxho, degustim i produkteve lokale, pjesëmarrje në aktivitetet e fermës, korrje dhe mbledhje e produkteve bujqësore lokale.
- b. Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale: bar / restorante me ushqime dhe pije lokale, blerje të produkteve lokale, mësim i proceseve të përpunimit dhe përgatitjes së produkteve e specialiteteve lokale.

4. Turizmi i aventurës dhe sportit

- a. Turizmi argëtues dhe rekreativ: aktivitete të ndryshme: mountain-board, accrobranches, kërcim me elastik, xhiro me balonë, paintball, speed-mountain, tenis, volejboll, futboll, basketboll, ping-pong, zip-line, organizimi i garave të orientimit. Aktivitete dimërore: ski, slita, speed-riding, snow-kite, etj.
- b. Turizmi i çiklizmit: gara çiklistike, shëtitje me biçikleta, çiklizëm malor
- c. Turizmi i speleologjisë: vizita në shpella, speleologji
- ç. Turizmi i aeronautikës: parashutizëm, paragliding, sky-diving, parapent
- d. Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit: ecje në natyrë (hiking, trekking), alpinizëm, via ferrata

5. Turizmi urban

- a. Turizmi i eventeve: pjesëmarrje në evenimente, festivale, panairë, ekspozita, evente kulturore, sportive, folklorike, kinematografike, teatrale, bujqësore.
- b. Turizmi shëndetësor: shërbime dhe qendra kurative reumatologjike, kardiologjike, ortopedike, SPA, estetike, joga, fitnesi, dietetike, mjekësi alternative (kurim me bimë mjekësore).
- c. Turizmi i biznesit ose profesional: pjesëmarrje në konferenca, mbledhje dhe takime profesionale, pjesëmarrje në evente çertifikimi dhe formimi profesional.
- ç. Turizmi social dhe i solidaritetit: aktivitete me interes publik për të mbështetur popullsinë lokale, pjesëmarrje në kampe verore, aktivitete rekreative dhe edukative për njerëzit në pamundësi financiare, aktivitete sensibilizuese për grupet në nevojë.

Neni 13

Elemente që duhen trajtuar nga plane të tjera si PKS, PPV, PSV, etj.

1. Të gjitha institucionet publike do të duhet të detajojnë PKST-në më tej nëpërmjet hartimit të planeve dhe programeve sektoriale në nivel kombëtar, rajonal e vendor dhe planeve të përgjithshme vendore, duke marrë në konsideratë orientimet e përcaktuara në PKST.
2. Propozimet mbi infrastrukturën, krahas rritjes së popullsisë duhet të marrin në konsideratë edhe numrin maksimal të turistëve në sezonin e pikut, sipas dokumenteve të PKST-së.
3. Orientimet e ekonomisë lokale, punësimit dhe arsimimit duhet të konsiderojnë nevojat e industrisë të turizmit.
4. Arkitektura dhe elementet tradicionale të baneve si dhe elementet e arredimit urban tradicional duhet të ruhen dhe të promovohen edhe në ndërtimet e reja të lokaliteteve turistike.

Neni 14

Orientime për infrastrukturën rrugore në zonë

1. Kjo rregullore rekomandon si kusht të panegoçueshëm për zhvillimin e turizmit ndërhyrjet e mëposhtme:
 - a. Përmirësimin e rrugëve interurbane dytësore dhe atyre lokale me një gjerësi përkatësisht 8 dhe 6 m.
 - b. Përmirësime vendore për të trajtuar kthesat me rreze të vogël duke rritur sigurinë rrugore dhe shpejtësinë sipas kategorisë së rrugëve.
 - c. Shtimin e xhëpave anësore për t'iu mundësuar automjeteve që të ndalojnë në pika të ndryshme panoramike.
 - ç. Krijimin e një lidhjeje të re infrastrukturore nëpërmjet aksit rrugor Vuksanaj-Salcë, sipas rrugëve të ekonomive pyjore.
2. Rrugët: përmirësimi apo rikonstrukcioni i rrugëve duhet të bëhet sipas standardeve dhe klasifikimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Në rast se qeverisja vendore duhet të ndërtojë apo rikonstruktojë rrugë me qëllim sigurimin e aksesit në zonat turistike, ato duhet të ndërtohen mbi gjurmën e rrugës ekzistuese sipas kategorive që lejohen me ligj. Korsi të planifikohen në vlerën e tyre minimale të gjerësisë sipas legjislacionit në fuqi.



3. Xhepat e ndalimit: xhepat apo vendet anësore të ndalimit për të nxënë të paktën tre vetura me madhësi të bollshme dhe të rregullt duhen siguruar në intervale dy-tre (2-3) kilometërsh, përveç pikave popullore panoramike.
4. Xhepa panoramike: xhepat apo vendet anësore të ndalimit për të nxënë të paktën tre vetura me madhësi të bollshme dhe të rregullt duhen siguruar në pikat popullore panoramike.
5. Siguria rrugore: të gjitha rrugët që paraqesin rrezik për automjetet duhet të pajisen me mbrojtëse metalike (guardrail) sipas kategorisë së rrugës.

Neni 15

Aksesi në zonë dhe itineraret

1. Janë përcaktuar 5 itinerare kryesore të qarkullimit që i shtohen të gjitha rrugëve të brendshme dhe shtigjeve natyrore të lira apo të menaxhuara.
2. Në itineraret kryesore ndërthuret:
 - a. lëvizja e automjeteve me lëvizjen e këmbësorëve;
 - b. segmente për të gjithë përdoruesit me segmentet për alpinizëm, ecje në natyrë me segmente lundrimi;
 - c. itineraret lokale me ato ndërkufitare, pjesë të "Via Dinarika" apo "Majat e Ballkanit".
3. Itineraret kryesore unazore janë:
 - a. Unaza e jashtme e zonës: Shkodër - (Vau i Dejës/Postribë) - Koman - Grykëderdhja e Shalës - Dushaj (Fierzë) - Bajram Curri - Dragobi - Çerem - Mali i Zi - Vermosh - Tamarë - Koplík - Shkodër.
 - b. Unaza e brendshme "bërthamë": Shkodër (Koplík) - Bogë - Theth - Valbonë - Bajram Curri - Dushaj - Curraj - Vuksanaj - Kir - Postribë - Shkodër.
 - c. Unaza perëndimore: Shkodër - Postribë - Kir - Theth - Bogë - Dedaj (Razëm) - Koplík - Shkodër.
 - ç. Unaza lindore: Bajram Curri - Tropojë e Vjetër - Dobërdol - Çerem - Dragobi - Valbonë - Curraj i Epërm - Dushaj - Bajram Curri.
 - d. Itinerari lundruer¹ : Vau i Dejës - Koman - Guri i Lekës, Lumi i Shalës - Dushaj (Fierzë).

¹ Ky itinerar është pjesë e unazës së jashtme të zonës.

Neni 16

Transporti publik turistik

1. Në zonë synohet integrimi i transportit publik të bashkive me atë ndërqytetar si dhe përcaktimi i linjave shtesë gjatë sezonit turistik si më poshtë:
2. Transport publik turistik me autobuza / mikrobuza²
 - a. Linja Bajram Curri – Tropojë
 - b. Linja Bajram Curri – Dushaj – Lekbibaj - Curraj i Epërm
 - c. Linja Bajram Curri – Valbonë – Çerem
 - ç. Linja Koplík - Tamarë – Vukël – Nikç
 - d. Linja Koplík – Tamarë – Lëpushë – Vermosh – Çerem – Bajram Curri ,
 - dh. Linja Koplík – Bogë – Theth – Kiri – Shkodër
 - e. Linja Koplík - Razëm
 - ë. Linja Shkodër – Kiri – Vuksanaj – Lekbibaj – Bajram Curri
3. Transport publik turistik liqenor
 - a. Linja Vau i Dejës – Koman
 - b. Linja Koman – Fierzë (Dushaj)
 - c. Linja Fierzë (Poravë) - Kukës
 - ç. Për të siguruar vazhdimësinë e itinerarit liqenor ndërthuret transporti me traget me atë me autobuza në segmentet:
 - Koman: Koman i Poshtëm – Koman i Sipërm
 - Fierzë: Dushaj - Poravë
4. Termialet intermodale duhet të ndërtohen në lokalitetet e nivelit të parë si Koplík dhe Bajram Curri, të cilat duhet të jenë të pajisura me të gjitha lehtësitat e nevojshme dhe shërbimet e udhëtimit turistik, duke i ofruar turistëve mundësinë e parkimit të automjeteve private në terminal dhe më pas përdorimin e transportit publik si alternativë për të minimizuar ndotjen e mjedisit nga emetimet e gazeve.
5. Stacionet duhet të ndërtohen në lokalitetet e nivelit të II dhe të III, ku duhet të kenë parkime për automjetet private, taksi 4+1 dhe parkime për autobuzet e linjave turistike.
6. Standardi minimal i parkimit publik (administrim publik ose privat) është:
 - a. Për parkimin publik, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, është 6m² / përdorues ose 1 vendparkim prej 12 m² për çdo 2 përdorues.

² Transporti publik duhet të jetë efektiv që nga momenti i ndërtimit të segmenteve rrugore.

³ Ka kalim të detyruar në territorin e Malit të Zi për t'u rregulluar me marrëveshje dypalëshe.



- b. Në të gjitha rastet të parashikohen vendpikime për personat me aftësi të kufizuara.
 - c. Parkimet publike duhet të kenë vende parkimi për autobuzët turistikë në varësi të frekuentimit të lokalitetit.
7. Çmimi i parkimit për automjetet private, me qëllim frenimin e hyrjes së tyre në zonën e alpeve dhe promovimin e transportit publik, duhet të jetë ndarë nga ai më i lartë tek ai më i ulët, sipas tre kategorive, që janë:
- a. Çmimi për parkimin në lokalitetet e nivelit të III
 - b. Çmimi për parkimin në lokalitetet e nivelit të II
 - c. Çmimi për parkimin në lokalitetet e nivelit të I
8. Në limanet Dushaj dhe Koman, përveç ankorimit të mjeteve lundruese publike duhet të parashikohen edhe vendqëndrime për mjetet lundruese private.
9. Çdo strukturë turistike duhet të sigurojë numrin e nevojshëm të parkimeve në funksion të numrit të dhomave, duke siguruar minimalisht 1 parkim për 5 dhoma.

Neni 17

Orientime për pika dhe akse panoramike (itinerare)

1. Territori karakterizohet nga vlera të larta peizazhstike dhe panoramike, por ka pika apo akse që kanë një vlerë më të lartë panoramike. Rregullat e mëposhtme synojnë ruajtjen dhe vlerësimin e këtyre zonave.
2. Pikat e vrojtimit të peizazhit:
 - Nuk duhet zënë pamja;
 - Nuk duhet të ketë objekte të ndërtuara;
 - Duhet menaxhuar bimësia që të jetë i lirë këndi viziv;
 - Duhet të ketë ndriçim artificial të kufizuar për të mos rritur ndotjen vizive të qiellit gjatë natës;
 - Duhet evidentuar me anë të studimeve të siluetës urbane dhe natyrore elementet që nuk përputhen me vlerat e peizazhit dhe duhen parashikuar masa rekuperuese të tij;
 - Duhet siguruar një akses publik;
 - Duhet përcaktuar elementet e arredimit urban dhe sinjalistika në përputhje me karakteristikat natyrore ose urbane të çdo pike

vrojtimi.

3. Akset panoramike (itineraret)

- Duhet ruajtur vazhdimësia e pamjes përgjatë aksit duke shmangur fragmentim të peizazhit;
- Duhet krijuar xhepa dhe zona buferike të këndvështrimeve pranë pikave me interes peizazhistik natyror dhe kulturor;
- Duhet evidentuar me anë të studimeve të siluetës urbane dhe natyrore elementet që nuk përputhen me vlerat e peizazhit dhe duhen parashikuar masa rekuperuese të tij;
- Duhet projektuar si elemente të unifikuara pjesët përbërëse të rrugës: panelet e sinjalistikës rrugore dhe turistike, elementet e mbrojtjes rrugore në gjuhë arkitektonike dhe në materiale;
- Duhet ruajtur elementet tradicionale, muret në të thatë e me thupra, urat etj.;
- Duhet shmangur asfalti në zonat natyrore dhe lokalitetet e nivelit 4 dhe në pjesën më të madhe të lokaliteteve të nivelit III;
- Xhepat panoramike dhe të ndalimit duhet të trajtohen jo si zona të asfaltuara, por me material të inxhinierisë natyrore në zgjidhjet e skarpatave dhe kanaleve kulluese;
- Gjelbërimi përgjatë akseve dhe veçanërisht në zonat e banuara duhet të trajtohet si i njëtrajtshëm;
- Duhet kontrolluar ndriçimi për të mos rritur ndotjen vizive të qiellit gjatë natës;
- Në shtigjet natyrore duhet ruajtur gjurma e tyre duke u kujdesur për bimësinë dhe sinjalistikën pranë tyre;
- Duhet ruajtur akses publik në të gjitha akset dhe shtigjet e zonës.

Neni 18

Orientime për sinjalistikën e shtigjeve

1. Shtigjet natyrore apo rrugët me bazament natyror të formuar për kalimin e këmbësorëve apo biçikletave malore duhet të përmirësohen pa dëmtuar mjedisin dhe të pajisen me sinjalistikën e posaçme, në gjuhë shqipe dhe të huaj.
2. Shtigjet natyrore të menaxhuara duhet të mirëmbahen dhe të pajisen me sinjalistikë. Në fillim të çdo shtegu duhet të vendoset një tabelë informuese ku të shënohet: i) origjina dhe destinacioni, ii) gjatësia, iii) kohëzgjatja, iv) ngjitja

dhe v) pikat e interesit.

3. Rrjeti i shtigjeve përfshin të gjitha shtigjet e ecjeve me këmbë dhe biçikleta, shtigjet malore dhe ato alpine të lidhura së bashku. Ai shtrihet jashtë zonave të banuara dhe bën aksesimin e zonave veçanërisht për qëllime argëtimi, peizazhistike, kulturore, historike dhe infrastrukture turistike.

4. Shtigjet për këmbësorë klasifikohen si më poshtë:

- Shtigje për ekskursion për këmbësorë të aksesueshme nga të gjithë, kryesisht nga grupet e ekskursionistëve të ndryshëm. Këto shtigje shtrihen larg rrugëve me trafik të motorizuar dhe janë të pajisura me shkallë të pjerrëta, me mbrojtëse anësore dhe ura kalimi nëse është e nevojshme. Përdorimi i këtyre shtigjeve është i mundur nga një numër i gjerë vizitorësh dhe shfaq një nivel vështirësie të ulët.
- Shtigje malore për këmbësorë, të cilat janë pjesërisht të vështira për t'u kaluar. Ato janë kryesisht të pjerrëta dhe të ngushta dhe ndonjëherë të ekspozuar. Pjesët e vështira janë të siguruar me litarë ose zinxhirë. Rrjedhat e ujit kalohen me kapërcim. Përdorimi i këtyre shtigjeve kërkon një njohje dhe eksperiencë të terrenit malor, një formë fizike të përshtatshme, por dhe mjete të sigurisë dhe orientimit në territor.
- Shtigje alpine për këmbësorë, të cilat janë pjesërisht në natyrë të lirë dhe mund të përfshijnë kalimet e zonave me dëborë, akull-

shkëmbinj dhe rrëpira me gurë. Përdorimi i këtyre shtigjeve kërkon një njohje të mirë të terrenit malor, kompetenca fizike specifike, aftësi të mira orientuese, mjete dhe pajisje që garantojnë sigurinë dhe orientimin e përdoruesve etj.

5. Çdo shteg duhet të jetë i pajisur me sinjalistikën e nevojshme në fillim të tij dhe përgjatë tij. Në fillim të çdo shtegu duhet të vendoset një panel druri me hartën përkatëse në të cilën të tregohet destinacioni, distanca, lloji i shtegut, shkalla e vështirësisë, ballkonet panoramike, etj. Gjithashtu, shtigjet duhet të jenë të pajisura me linja telefonike, të cilat mund të përdoren në raste emergjence.

6. Sinjalistika mund të përgatitet me materiale prej druri të cilat nuk ndotin mjedisin. Në disa raste mund të përdoren trungjet e pemëve, mbi të cilat sinjalet mund të shënohen me bojë dhe duhet të plotësojnë disa kriteret si më poshtë:

- a. Shikueshmëri nga një distancë e konsiderueshme;
- b. Nëse është e mundur, orientimi duhet të jetë ballor në raport me drejtimin e ecjes;
- c. Aplikimi i tyre duhet të jetë gjithmonë në të dyja drejtimet;
- ç. Vendosja e tyre duhet të jetë në një lartësi prej 160 cm;
- d. Sinjalet nuk duhet të mbulohen nga bimësia përreth;
- dh. Në pemë përdoret gjithmonë bojë dhe asnjëherë vidë apo gozhdë.

	Shteg ekursioni për këmbësorë	Shteg malor për këmbësorë	Shteg alpin për këmbësorë
Sinjali			
Informacion shtesë			
	Shteg ekursioni	Shteg malor	Shteg alpin
Programi i lëvizjes			
			Shembull

Shembull sinjalistike



Neni 19

Orientime mbi administrimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të përdorur

1. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit për plotësimin e nevojave të popullsisë së zonës rurale dhe përballimin e kërkesës për ujë gjatë periudhës së pikut turistik.
2. Duke u nisur nga topografia e terrenit dhe vendndodhja e burimeve, në pjesën më të madhe të zonës rekomandohet aplikimi i sistemeve të ujësjellësve me vetërrjedhje.
3. Të ndërtohen impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur dhe të bëhet e mundur përfshirja sa më e gjerë e komuniteteve ndaj këtij shërbimi.
4. Të ndalohet shkarkimi në mjedis i ujërave të ndotur të patrajtuar. Për lokalitetet apo strukturat e izoluara që nuk kanë mundësi për t'u lidhur me një rrjet publik kanalizimesh, autoritetet përgjegjëse duhet të marrin masa për ndërtimin e sistemeve komunitare të trajtimit të ujërave të ndotur.

Neni 20

Orientime mbi trajtimin e vijave të ujit (lumenj, përrenj të përhershëm dhe sezonalë)

1. Të ndalohet përdorimi i brigjeve dhe shtretërve të lumenjve e përrenjve si rrugë kalimi për këmbësoret dhe mjetet motorike. Të mundësohet krijimi i servituteve dhe infrastrukturave të nevojshme për akses të sigurtë dhe që nuk cënon mjedisin.
2. Të merren masa për mbrojtjen nga ujërat e larta dhe përmytjet duke ndërtuar prita malore, kanale dhe argjinatura mbrojtëse.
3. Të zbatohet mirëmbajtja e pyjeve dhe të aplikohen programet e pyllëzimit të djerrinave për kontrollin dhe parandalimin e erozionit.

Neni 21

Orientime mbi trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane

1. Të krijohen strukturat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe të zbatohen programe për aplikimin e kompostimit në bazë shtëpie apo ferme.
2. Të instalohen kontejnerë elektromekanikë kompostimi që t'i shërbejnë një apo më shumë

lokaliteteve.

3. Të ndalohen koshat e hedhjes së mbeturinave në zona dhe shtigje natyrore. Të vendosen tabela informuese për vizitorët se si duhet të veprojnë në këto raste.

Neni 22

Orientime mbi shërbimin e telekomunikacionit

1. Të mundësohet mbulimi i gjithë zonës së alpeve me valë të telefonisë mobile.
2. Të ndërtohet rrjeti i telefonisë fikse dhe të hapen numrat treshifrorë për kërkimin e ndihmës së shpejtë.

Neni 23

Orientime mbi energjinë dhe burimet alternative

1. Të përmirësohet rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë zonën dhe të shtohet kapaciteti i rrjetit për të përballuar konsumin gjatë periudhës së pikut turistik.
2. Të ndërmerren programe për nxitjen e përdorimit të energjisë alternative, kryesisht të energjisë diellore, që mund të përdoret si burim nxehtësie dhe energji elektrike nëpërmjet sistemeve fotovoltaike.
3. Autoritetet përgjegjëse të marrin masa për të detyruar përdorimin e filtrave me qëllim pakësimin e gazrave ndotëse nga përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje.

Neni 24

Orientime për trajtimin arkitektonik të strukturave

1. Në zhvillimet e reja dhe në rehabilitime, duhet të mbahet parasysh karakteri rural apo urban i lokaliteteve.
2. Në lokalitete promovohen elementet e arkitekturës tradicionale:
 - a. Në objektet e banimit të vazhdojë përdorimi i derës me hark;
 - b. Çatitë një ose dy ujëse të ndërtohen me dërrasa dhe me tjegulla - dru pishe dhe të jenë të shfrytëzueshme;
 - c. Krijimi i ballkoneve karakteristike (shameshin);



- ç. Përdorimi i shkallëve të drurit të jashtme edhe si element fasade;
 - d. Fashatura druri për dritaret;
 - dh. Ruajtje e tipologjive karakteristike të ndërtimeve të objekteve kryesisht në zonat alpine;
 - e. Në bujtina mund të përfshihen tavane druri të punuara në stilin tradicional si dhe ndarja e ambienteve me dollapë po druri.
3. Arkitektura tradicionale shquhet për përdorimin e materialeve dru dhe gur në fasada më shumë sesa ngjyra. Në ndërtimet e reja mund të përfshihen ngjyrat duke i harmonizuar dhe ndërthurur me elementet e fasadave tradicionale.
 4. Në lokalitete ku nuk mbizotëron arkitektura tradicionale, mund të lejohen objekte me arkitekturë bashkëkohore, gjithmonë në ruajtje dhe harmonizim me peizazhin dhe traditën lokale.
 5. Ndalohen kategorikisht elementet që risjellin stile dhe gjuhë arkitektonike të huaja në zonë: arkitekturë neoklasike, neo-baroke etj.
 6. Muret rrethuese duhet të jenë jo masive dhe duhet të promovohet përdorimi i gardheve sipas tipologjive ekzistuese:
 - a. Me listela dhe kërcinj druri të vendosur vertikalisht ose horizontalisht
 - b. Me thupra / purteka me thurje
 - c. Me gurë vendosur në të thatë (pa llaç)
 7. Ndërhyrjet në struktura me qëllim rritjen e efikasitetit termik do të konsiderohen me prioritet.
 8. Duhet të promovohet zëvendësimi i çatave me eternit, me llamarinë apo me tjegulla jo tradicionale, me çati me rrasa pishe – tradicionale të zonës.
- Neni 25**
Orientime për llojet e strukturave akomoduese
1. Në territorin e përfshirë në PKST – Alpe lejohen këto tipologji strukturash turistike: bujtina, fjetje & mëngjes, fjetina, hotele, resorte, kamping, qendra kurative, motele, strehime alpine, sipas skedave të lokaliteteve.
 2. Kategoria e bujtinave, fjetje & mëngjes dhe fjetinave ka përparësi nëse përdor struktura të banesave ekzistuese. Në oborret e banesave lejohen:
 - a. Vendosja e kampingjeve mikse duke ofruar kushtet e nevojshme të infrastrukturës dhe duke zënë jo më shumë se 20% të oborrit.
 - b. Vendosja e strukturave të përkohshme të drurit si rritje të kapacitetit akomodues dhe ofrimi i shërbimeve gastronomike dhe rekreative.
 - c. Krijimi i këndeve rekreative dimërore dhe verore.
 3. Kategoria e hoteleve ndahet në 4 nënkategorit sipas kapacitetit dhe llojit të strukturës:
 - a. Hotele me kapacitet të ulët (6-20 dhoma)
 - b. Hotele me kapacitet të mesëm (20 - 50 dhoma)
 - c. Hotele me kapacitet të lartë (50 dhoma e më shumë)
 - ç. Hotele të shpërndara
 4. Resortet, duhet të mbështeten nga një studim fizibiliteti dhe kapaciteti, me struktura që respektojnë dimensionet dhe elementet arkitektonike autoktone të zonës (neni 24).
 5. Qendrat kurative duhet të respektojnë dimensionet dhe elementet arkitektonike autoktone të zonës (neni 24).
 6. Kampingu ndahet në:
 - a. Kamping me çadra – i lejuar në të gjithë territorin, në përputhje me planet e menaxhimit të parqeve.
 - b. Kamping për kamper – në sheshe të pajisur me infrastrukturë, në afërsi të vendbanimeve dhe akseve kryesore të lëvizjes si dhe në territore të parashikuara nga PPV-të.
 - c. Kamping miksi – në sheshe të pajisura me infrastrukturë, në afërsi të vendbanimeve dhe akseve kryesore të lëvizjes si dhe në territore të parashikuara nga PPV-të.
 - ç. Duhet të parashikohen shërbime higjienike (depozita septike), tualete, lavamane, dushe, nga 1 për çdo 4 çadra / kamper.
 - d. Qëndrimi i tendave dhe rulotëve duhet të jetë i përkohshëm dhe nuk duhet t'i kalojë 3 muaj në një hark kohor prej një viti.
 - dh. Të gjitha këto struktura duhet të respektojnë normativat për mbrojtjen nga zjarri.
 7. Strukturat e moteleve duhen kufizuar në territor.
 8. Strehimet alpine duhet të zhvillohen në kuota të larta, në zona me aksesibilitet të ulët pranë shtigjeve këmbësore, të biçikletave dhe skive. I jepet përparësi transformimit të strukturave të staneve në strehime alpine përpara zhvillimit të strukturave të reja. Ndërtesat e reja duhet të integrohen në peizazhin natyror malor duke



përdorur materiale lokale dhe morfologjinë e terrenit.

9. Lejohen transformimet e të gjitha objekteve ekzistuese në zonë në këto tipologji strukturash akomodimi: bujtina, fjetje & mëngjes, fjetina, hotele, hotele të shpërndara, strehime alpine, qendra kurative.
10. Në strukturat e reja të vendbanimeve ekzistuese duhet të prioritetizohen elementet e arkitekturës tradicionale sipas nenit 24 të kësaj rregulloreje.
11. Strukturat e reja akomoduese jashtë vendbanimeve duhen të bazohen në rekomandimet e Planeve të Menaxhimit të Parqeve, zonimin dhe rregullat arkitektonike të PPV-ve.
12. Në zhvillimet e territorit, prioritet duhet të kenë ndërhyrjet në rehabilitimin dhe transformimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave të kampingut.

Neni 26

Orientime për struktura të veçanta

1. Struktura për sporte dimri – ski, duhen të konsiderohen me interes publik dhe të klasifikohen sipas një rregulloreje dhe legjislacioni të veçantë. Kategorizimi i mëposhtëm është orientues për identifikimin e mundësive në territor.
 - a. Pista zbritjeje
 - b. Pista për ski nordike
 - c. Pista për sporte të tjera: slita, snowtubing etj.
 - ç. Pista për trampolina me ski
 - d. Zona të rezervuara për aktivitete akrobatike me ski dhe snowboard (parqe bore)
 - dh. Shtigje të shënuara jashtë piste
- Rregullorja dhe identifikimi në territor i strukturave për sporte dimri duhen të marrin në konsideratë rregullat e planeve të menaxhimit të parqeve kombëtare dhe rajonale, rregullat e kësaj rregulloreje dhe rregullat e PPV-ve. Si parakusht për shqyrtimin e kërkesave dhe aplikimeve, është e rëndësishme që të hartohet një studim para-fizibiliteti që do të shtjellojë analizën territoriale, sociale, mjedisore dhe ekonomike të zonës së ndërhyrjes.
2. Strukturat mbështetëse në funksion të infrastrukturave (ujësjellës, kanalizime, energji, telekomunikacion, mbetje etj.) duhet të integrohen në peizazhin e zonës duke përdorur elemente të arkitekturës lokale.

KREU 3

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR LOKALITETET

Neni 27

Klasifikimi i lokaliteteve

1. Territoret ku do të zhvillohet turizmi klasifikohen në 4 nivele: bazuar në kërkesë/ofertën turistike, praninë në zonë të monumenteve të trashëgimisë kulturore, elementeve me arkitekturë tradicionale që duhet ruajtur dhe vlerave natyrore dhe peizazhiste të rrethinave të lokalitetit.
2. Niveli 1 përfshin lokalitetet hyrëse në zonën e PKST-së dhe karakterizohet nga shumëllojshmëri shërbimesh turistike, administrative, shëndetësore etj., si dhe një aktivitet njerëzor më i dendur.
3. Niveli 2 përfshin lokalitetet që kanë akses të mirë ose janë pranë akseve kryesore rrugore, kanë shërbime publike bazë, potencial për zhvillim të strukturave të ndryshme turistike, dhe ku rrethinat e lokaliteteve kanë avantazhe mjedisore e kulturore.
4. Niveli 3 përfshin lokalitetet “bërthamë” të Alpeve Shqiptare, ku ndërthuren vlera të larta mjedisore me karakteristika të arkitekturës tradicionale që duhet ruajtur. Synohet një ngarkesë turistike e ulët duke orientuar kërkesën në lokalitetet e nivelit 2.
5. Niveli 4 përfshin të gjitha territoret ku synohet promovimi i turizmit natyror, ruajtja e tipareve natyrore të lokaliteteve dhe ndikimi zero ose minimal i infrastrukturës.

Neni 28

Lokalitetet dhe rrezja e influencës

1. Në lokalitete përfshihen vendbanime ekzistuese dhe potenciali i tyre për densifikim dhe zgjerim sipas fshatrave përbërës të secilit lokalitet, të përcaktuara në skeda.
2. Rrezja e influencës orienton ndërveprimin e parë të turistit me territorin – distancën e shërbimeve dhe ofertës turistike natyrore dhe kulturore nga përqendrimi i strukturave akomoduese.
3. Rrezja e influencës është e lidhur me mundësitë e aksesit me automjete, biçikleta dhe këmbë.
4. Lokalitetet e nivelit të parë kanë një rreze influ-

ence ndërveprimi prej 20 km, bazuar në përqendrimin e shërbimeve kryesore: ekonomike, sociale dhe infrastrukturore që kanë dhe një ndikim më të lartë në territor. Janë zona të cilat do kenë mbulimin më të shpeshtë me transport publik si përgjigje e dendësisë urbane.

5. Lokalitetet e nivelit të dytë kanë një rreze influence prej 10 km, ku aksesimi ndodh kryesisht me automjete dhe janë lokalitete të mirë aksesueshme me potencial dhe lidhje me transportin publik.
6. Lokalitetet e nivelit të dytë, Koman dhe Dushaj kanë një rreze influence prej 3 km duke qenë se janë të lidhur me transportin liqenor dhe janë pika tranziti më shumë sesa lokalitete të mirë-fillta turistike.
7. Lokalitetet e nivelit të tretë dhe të katërt kanë një rreze influence prej 5 km dhe janë zona qendrore ku nxitet lëvizja në këmbë dhe me biçikleta, ndaj dhe distancat janë më të vogla.

Neni 29

Kapaciteti akomodues optimal

Kapaciteti akomodues turistik optimal për lokalitet shërben si një vlerë orientuese për numrin maksimal të shtretërve që mund të konsiderohen në një lokalitet, duke mos cënuar në mënyrë të ndjeshme karakteristikat mjedisore, sociale, ekonomike dhe kulturore të destinacionit turistik.

Bazuar në kërkesën aktuale të tregut, kapaciteti akomodues optimal ndahet në tre kategori kryesore strukturash akomoduese:

- **Grupi 1** – Struktura hoteliere, më të cilat nënkuptohen hotele, hotele të shpërndara, motele, qendra kurative, resorte;
- **Grupi 2** – Struktura akomoduese si: bujtina, fjetina, fjetje dhe mëngjes, strehim alpin;
- **Grupi 3** – Struktura akomoduese si: kamping me çadra dhe kamping për kamper.

Kategoritë e strukturave akomoduese do t'i përgjigjen kërkesës turistike dhe potencialit turistik të lokalitetit, duke mos cënuar arkitekturën, kulturën dhe karakterin e zonës.



Neni 30

Lokalitetet e nivelit 1 - Koplík

1	Fshatra ⁴	Koplík, Koplík i Sipërm, Zagorë, Lohë e Sipërme, Dedaj
2	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	Lokaliteti Koplík, ndodhet në afërsi të zonës së mbrojtur mjedisore të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit. Zhvillimi lokalitetit do të marrë në konsideratë Planin e Menaxhimit të Parkun Natyror Bashkiak të Shkrelit, ku identifikohen nën-zonat: <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e shërbimeve të vizitorëve; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm; dhe Rezervatin Natyror të Menaxhuar/ Parku Natyror i Liqenit të Shkodrës (VKM nr. 684, datë 02.11.2005). Në lokalitet dhe në afërsi të tij gjenden monumente kulture dhe natyre.
3	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi argëtues dhe rekreativ • Turizmi i eventeve • Turizmi ujor • Turizmi i biznesit ose profesional
4	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi i historisë dhe kulturës lokale • Turizmi industrial dhe artizanal • Turizmi krijues • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi shëndetësor • Turizmi social dhe i solidaritetit
5	Shembuj aktivitesh sipas turizmit kryesor	Aktivitete të ndryshme rekreative si: shëtitje me biçikleta, xhiro me balonë, shëtitje në liqen, tenis, volejball, futboll, basketboll, ping pong, <i>paint-ball</i> etj. Pjesëmarrje në evenimente, festivale, panaire, ekspozita në fusha të ndryshme si: kultura, sporti, folklori, kinematografia, teatri, bujqësia etj. Përdorimi i liqenit të Shkodrës për aktivitete nautike, si p.sh.: vizita në brigje dhe gjire natyrore me vlera peizazhiste ose gjeomonumente ujore; aktivitete ujore si peshkim, kanoe, not, <i>waterballs</i> etj. Pjesëmarrje në aktivitete profesionale, si: konferenca, mbledhje dhe takime profesionale, pjesëmarrje në evenimente certifikimi dhe formimi profesional etj.
6	Tipologjia e strukturave akomoduese	Hotel me kapacitet të lartë, hotele me kapacitet të mesëm, hotele me kapacitet të ulët, shtëpi ose banesa me qira, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks, motel.

⁴ Bazuar në Ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

**Lokalitetet e nivelit 1 - Koplík**

7	Kapaciteti akomodues	Aktual	Optimal
		<p><i>Total:</i> 120 shtretër</p> <p>Hotel: 70 shtretër Bujtina: 0 shtretër Kamping: 50 shtretër</p>	<p><i>Total:</i> 600-650 shtretër</p> <p>Grupi 1: 550 shtretër Grupi 2: 0 shtretër Grupi 3: 100 shtretër</p>
8	Parkimet e nevojshme për turistët	<p>60-70 vende parkimi publik për turistët</p> <p>Parkimet e terminalit turistik dhe pikës informative e logjistike, të papërfshira në vlerën e mësipërme, do të përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.</p>	
9	Ndërrhyrjet e nevojshme	<p>Pikë lidhëse e turizmit malor me atë liqenor (Liqeni i Shkodrës), përmirësimi i infrastrukturës të transportit.</p> <p>Sistemimi i hapësirës për terminalin turistik dhe pikë informative dhe logjistike në funksion të turizmit malor.</p> <p>Ndërtimi i strukturave të shërbimeve turistike: infopoint, dyqane, dhënie me qira automjeteve dhe pajisjesh për turizmin e aventurës dhe sportit.</p> <p>Përmirësim i infrastrukturës rrugore hyrëse në alpe. Lidhja e turizmit me aktivitetet bujqësore të fshatit: tregje, panaire etj.</p>	
10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë plani i menaxhimit të Rezervatit Natyror të Liqenit të Shkodrës.</p> <p>Lokaliteti i Koplikut, një zonë e konsoliduar urbane ndryshe nga lokalitetet e tjera më të ndjeshme nga pikëpamja mjedisore, është pika në të cilën takohet turizmi malor me atë liqenor. Në këtë lokalitet synohet zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për turizmin.</p> <p>Duhet të merren në konsideratë parashikimet e PPV Malësi e Madhe. Synohet ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore. Në zonë, krahas strukturave akomoduese, duhet të orientohet zhvillimi i strukturave të shërbimeve tregtare turistike dhe gastronomike.</p> <p>Gërshetim i turizmit natyror dhe atij të bizneseve dhe konferencave të lidhur me prodhimin ekonomik dhe bujqësor. Krijimi i një qendre turistiko-logjistike, e cila do të ketë në fokus kryesisht turistët, por do të shërbejë edhe për banorët.</p> <p>Kjo qendër synon të krijojë një pol të ri zhvillimi të dedikuar kryesisht për turistët. Rigjallërimi i hapësirës së zgjedhur do të ndikojë në përmirësimin e hapësirës publike nga ana arkitektonike dhe funksionale duke integruar shërbime të nevojshme për turistët. Përmirësimi i rrjetit infrastrukturor, veçanërisht segmenti Koplík - Koplík i Sipërm - Dedaj si rrugë hyrëse për në alpet perëndimore.</p> <p>Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale.</p>	



Neni 31

Lokalitetet e nivelit 1 - Bajram Curri

1	Fshatra ⁵	Bajram Curri, Bujan, Gri, Lëkurtaj, Selimaj, Margegaj, Dojan, Bllatë, Koçanaj, Shoshan, Markaj, Babinë
2	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Në afërsi të lokalitetit të Bajram Currit, ndodhen zonat e mbrojtura mjedisore të Parkut Kombëtar të Alpeve dhe Parkut Natyror Bashkiak Nikaj – Mërtur.</p> <p>Zhvillimi i lokalitetit do të marrë në konsideratë Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e menaxhimit efektiv; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm; <p>dhe Planin e Menaxhimit të Parkut Natyror Bashkiak Nikaj – Mërtur, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. <p>Në lokalitet dhe në afërsi të tij gjenden monumente kulture dhe natyre.</p>
3	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i historisë dhe kulturës lokale • Turizmi argëtues dhe rekreativ • Turizmi i eventeve • Turizmi i biznesit ose profesional • Turizmi shëndetësor
4	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi malor dhe hapësirave natyrore • Turizmi ujor • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi industrial dhe artizanal • Turizmi krijues • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi social dhe i solidaritetit
5	Shembuj aktivitesh sipas turizmit kryesor	<p>Vizita në muzeun e Bajram Currit dhe në monumentet e kulturës, kulla historike, vende historike dhe legjendare, galeri arti, njohje me zakonet dhe rregullat sociale të zonës, folklorin dhe legjendat lokale, kurse kërcimi të valleve popullore dhe të mësimin të veglave muzikore lokale, udhëtime nëpër itinerare kulturore etj.</p> <p>Aktivitete të ndryshme rekreative si: shëtitje me biçikleta, xhiro me balonë, tenis, volejball, futboll, basketboll, ping pong, paint-ball, zip-line, si dhe aktivitete dimërore si ski dhe slita, etj.</p> <p>Pjesëmarrje në evenimente, festivale, panaire, ekspozita në fusha të ndryshme si: kultura, sporti, folklori, kinematografia, teatri, bujqësia etj.</p>

⁵ Bazuar në Ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"



Lokalitetet e nivelit 1 - Bajram Curri

5	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	Pjesëmarrje në aktivitete profesionale, si: konferenca, mbledhje dhe takime profesionale, pjesëmarrje në evenimente certifikimi dhe formimi profesional etj. Shërbime në qendra kurative reumatologjie, kardiologjie, ortopedie, SPA, qendra estetike, joga, fitnesi, dietetike, mjekësi alternative etj.	
6	Tipologjia e strukturave akomoduese	Hotele me kapacitet të lartë, hotele me kapacitet të mesëm, hotele me kapacitet të ulët, motel, shtëpi ose banesa me qira, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks.	
7	Kapaciteti akomodues	Aktual	Optimal
		Total: 350 shtretër Hotel: 350 shtretër Bujtina: 0 shtretër Kamping: 0 shtretër	Total: 500-550 shtretër Grupi 1: 500 shtretër Grupi 2: 0 shtretër Grupi 3: 100 shtretër
8	Parkimet e nevojshme për turistët	50-60 vende parkimi publik për turistët Parkimet e terminalit turistik dhe pikës informative e logjistike të papërfshira në vlerën e mësipërme, do të përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.	
9	Ndërhyrjet e nevojshme	Sistemimi i hapësirës për terminalin turistik. Ndërtimi i strukturave të shërbimeve turistike: infopoint, dyqane, dhënie me qira automjeteve dhe pajisjesh për turizmin e aventurës dhe sportit. Përmirësim i infrastrukturës rrugore hyrëse në alpe. Lidhja e turizmit me aktivitetet kulturore dhe administrative të qytetit: muze, teatër, kinema, stadium, biblioteke, si dhe aktivitetet bujqësore të fshatrave përreth: tregje e panaire etj. Ndërtimi i një landfilli për mbetjet në bashkinë e Tropojës që do t'i shërbejë të gjithë anës lindore të Alpeve Shqiptare dhe lokaliteteve në afërsi të qytetit të Bajram Currit.	
10	Kushte specifike për zhvillim	Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve dhe Parkut Natyror Bashkiak Nikaj – Mërtur. Lokaliteti i Bajram Currit është një zonë e konsoliduar urbane ndryshe nga lokalitetet e tjera që janë më të ndjeshme nga pikëpamja mjedisore. Ajo është pika në të cilën takohet turizmi malor me atë urban. Në këtë lokalitet synohet zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për turizmin. Duhet të merren në konsideratë parashikimet e PPV Tropojë. Synohet ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore. Në zonë, krahas strukturave akomoduese duhet të orientohet zhvillimi i strukturave të shërbimeve tregtare turistike dhe gastronomike.	



Lokalitetet e nivelit 1 - Bajram Curri

10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Gërshetim i turizmit natyror dhe atij të bizneseve e konferencave të lidhur me prodhimin ekonomik dhe bujqësor.</p> <p>Krijimi i një qendre turistiko-logjistike, e cila do të ketë në fokus kryesisht turistët, por do të shërbejë edhe për banorët.</p> <p>Kjo qendër synon të krijojë një pol të ri zhvillimi të dedikuar kryesisht për turistët. Rigjallërimi i hapësirës së zgjedhur do të ndikojë në përmirësimin e hapësirës publike nga ana arkitektonike dhe funksionale, duke integruar shërbime të nevojshme për turistët.</p> <p>Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale.</p>
----	-------------------------------	---



Neni 32

Lokalitetet e nivelit 2 - Vermosh

1	Fshatra ⁶	Vermosh
2	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Lokaliteti Vermosh ndodhet në zonë e mbrojtur mjedisore të Parkut Kombëtar të Alpeve.</p> <p>Zhvillimi i lokalitetit do të bazohet në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none">• Zonë qendrore;• Zonë e menaxhimit efektiv;• Zonë e përdorimit tradicional;• Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. <p>Në lokalitet gjenden pasuri natyrore, peizazhistike si dhe gjurmë të ngjarjeve historike.</p>
3	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none">• Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit• Turizmi malor dhe hapësirave natyrore• Turizmi i parqeve dhe zonave të mbrojtura• Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore• Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale• Turizmi i qëndrueshëm / ekoturizëm / ekologjik
4	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none">• Turizmi i historisë dhe kulturës lokale• Turizmi i aeronautikës• Turizmi industrial dhe artizanal• Turizmi shkencor• Turizmi krijues• Turizmi argëtues dhe rekreativ• Turizmi i çiklizmit• Turizmi i eventeve• Turizmi shëndetësor• Turizmi social dhe i solidaritetit
5	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	<p>Ecje dhe aktivitete në natyrë (hiking, trekking, alpinizëm, via ferrata etj.)</p> <p>Vizita në zona të mbrojtura, rezerva natyrore, monumente të natyrës etj.</p> <p>Shëtitje në natyrë dhe në shtigjet panoramike (në këmbë, kuaj dhe mushkë), vizita në monumente të natyrës (gjeomonumente, ujëvara, kanione, pyje, lumenj, përrenj, shpella, korridore të gjelbra), piknikë, shëtitje me ski, ski nordike, ecje me raketa, slita etj.</p> <p>Vizita në ferma bujqësore, blegtorale dhe baxho, degustim i produkteve lokale, pjesëmarrje në aktivitetet e fermës, korrije dhe mbledhje e produkteve bujqësore lokale etj.</p> <p>Frekuentimi i bareve dhe restoranteve me ushqime dhe pije lokale, blerje e produkteve lokale, mësimi i proceseve të përpunimit dhe përgatitjes të specialiteteve lokale etj.</p>

⁶ Bazuar në Ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"



Lokalitetet e nivelit 2 - Vermosh

5	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	<p>Vizita dhe ekskursionë në zona me biodiversitet të lartë, rezerva natyrore, parqe natyrore, studim i florës dhe faunës etj.</p> <p>Kurse dhe aktivitete sensibilizuese për problematikat mjedisore, për ruajtjen e biodiversitetin dhe specieve në zhdukje etj.</p>						
6	Tipologjia e strukturave akomoduese	Bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, hotele me kapacitet të ulët, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks, qendër kurative, shtëpi ose banesa me qira, resorte, strehim alpin.						
7	Kapaciteti akomodues	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 50%; text-align: center;">Aktual</th> <th style="width: 50%; text-align: center;">Optimal</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">Total: 157 shtretër</td> <td style="text-align: center;">Total: 950-1000 shtretër</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">Hotel: 16 shtretër Bujtina: 141 shtretër Kamping: 0 shtretër</td> <td style="text-align: center;">Grupi 1: 225 shtretër Grupi 2: 575 shtretër Grupi 3: 200 shtretër</td> </tr> </tbody> </table>	Aktual	Optimal	Total: 157 shtretër	Total: 950-1000 shtretër	Hotel: 16 shtretër Bujtina: 141 shtretër Kamping: 0 shtretër	Grupi 1: 225 shtretër Grupi 2: 575 shtretër Grupi 3: 200 shtretër
Aktual	Optimal							
Total: 157 shtretër	Total: 950-1000 shtretër							
Hotel: 16 shtretër Bujtina: 141 shtretër Kamping: 0 shtretër	Grupi 1: 225 shtretër Grupi 2: 575 shtretër Grupi 3: 200 shtretër							
8	Parkimet e nevojshme për turistët	<p>95-105 vende parkimi publik për turistët</p> <p>Parkimet e stacioneve turistike dhe pikës informative e logjistike, të papërfshira në vlerën e mësipërme, do të përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.</p>						
9	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Sistemimi i rrugës hyrëse dhe ndërtimi i infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve publike.</p> <p>Krijimi i parkimeve publike të përshtatura edhe për autobuzë. Përcaktimi dhe vendosja e sinjalistikës në shtigjet drejt bjeshkëve dhe kullovave alpine (staneve), potenciale për zhvillimin e sporteve dimërore.</p> <p>Rinovimi i bujtinave në përshtatje me arkitekturën tradicionale.</p> <p>Pika promovimi dhe tregtimi të produkteve tradicionale gastronomike, etnografike dhe të artizanatit.</p> <p>Pika shitjeje guidash dhe produktesh në funksion të turizmit. Identifikimi i hapësirave të nevojshme për ngritjen e kampingjeve.</p> <p>Trajnimi i mikpritësve në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit turistik për lokalitetin.</p>						
10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve.</p> <p>Duhet të merren në konsideratë parashikimet e PPV Malësi e Madhe.</p> <p>Ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore është primare për këtë zonë. Zona ka vlera të larta mjedisore dhe ndërhyrjet duhet të jenë të mirëorientuara në ruajtjen e tyre.</p> <p>Synohet shtimi i vendbanimeve ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave akomoduese në to përpara shtrirjes në zona të reja.</p>						

Lokalitetet e nivelit 2 - Vermosh

10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Zhvillimi i zonës duhet të marrë në konsideratë rigjallërimi e godinave aktualisht pa funksion, vlerësimin e peizazhit, ndërhyrjet rikualifikuese në bujtinat ekzistuese dhe ndërtimin e strukturave të reja akomoduese.</p> <p>Përparësi kanë rikonstruksionet dhe konvertimet e objekteve ekzistuese në bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, pika tregtimi, bare, restorante, etj. Rinovimi e përmirësimi i standardeve, dhe rritja e efijencës energjetike janë prioritet.</p> <p>Përmirësimi i infrastrukturës mbi shtratin e lumit është i nevojshëm për këtë zonë.</p> <p>Rehabilitimi i qendrës së fshatit për aktivitete të ndryshme sociale si festa tradicionale apo evente turistike. Zona duhet të pajiset me infrastrukturë të përshtatshme për këto aktivitete duke sistemuar edhe ndriçimin urban.</p> <p>Në bujtina lejohen vendosja e çadrave dhe rulotëve brenda pronësisë së bujtinës.</p> <p>Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra, strehime alpine si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën, si në parametra ashtu dhe në materiale. Përparësi kanë konvertimet e staneve në struktura akomoduese (rinovim, prishje dhe rindërtim).</p> <p>Përparësi ka dhe krijimi i një pike informacioni dhe shërbimesh pranë pikës kufitare.</p>
----	-------------------------------	--



Neni 33

Lokalitetet e nivelit 2 - Tamarë-Selcë

1	Fshatra ⁷	Tamarë, Broja, Kozhnje, Selcë
2	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Lokaliteti Tamarë-Selcë, ndodhet në afërsi të zonës së mbrojtur mjedisore të Parkut Kombëtar të Alpeve.</p> <p>Zhvillimi i lokalitetit do të marrë në konsideratë Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e menaxhimit efektiv; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. <p>Në lokalitet gjenden pasuri natyrore dhe peizazhistike.</p>
3	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi malor dhe hapësirave natyrore • Turizmi ujor • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi argëtues dhe rekreativ
4	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i historisë dhe kulturës lokale • Turizmi industrial dhe artizanal • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi krijues • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i aeronautikës • Turizmi i eventeve • Turizmi shëndetësor
5	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	<p>Shëtitje në natyrë dhe në shtigje panoramike (në këmbë, kuaj dhe mushkë), vizita në monumente të natyrës (gjeomonumente, ujëvara, kanione, pyje, lumenj, përrenj, shpella, korridore të gjelbra), piknikë, shëtitje me ski, ski nordike, ecje me raketa, slita etj.</p> <p>Përdorimi i rrjedhës së lumit për aktivitete nautike, si p.sh.: vizita në brigje me vlera peizazhistike, gjeomonumente ujore, aktivitete ujore si peshkim, kanoe, kajak, rafting, canyoning, not etj.</p> <p>Frekuentimi i bareve dhe restoranteve me ushqime dhe pije lokale, blerje e produkteve lokale, mësimi i proceseve të përpunimit dhe përgatitjes të specialiteteve lokale etj.</p> <p>Ecje dhe aktivitete në natyrë (hiking, trekking, alpinizëm, via ferrata etj).</p> <p>Aktivitete të ndryshme rekreative si: shëtitje me biçikleta, mountain-bike, xhiro me balonë, mountain-board, kërcim me elastik, tenis, volejboll, futboll, basketboll, ping pong, paint-ball, zip-line, gara orientimi, aktivitete dimërore si ski, slita, snow-kite, ecje me raketa etj.</p>

⁷ Bazuar në Ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

Lokalitetet e nivelit 2 - Tamarë-Selcë

6	Tipologjia e strukturave akomoduese	Bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks, hotele me kapacitet të ulët, qendër kurative, shtëpi ose banesa me qira, resorte.	
7	Kapaciteti akomodues	Aktual	Optimal
		Total: 22 shtretër Hotel: 0 shtretër Bujtina: 22 shtretër Kamping: 0 shtretër	Total: 600-650 shtretër Grupi 1: 150 shtretër Grupi 2: 350 shtretër Grupi 3: 150 shtretër
8	Parkimet e nevojshme për turistët	60-70 vende parkimi publik për turistët Parkimet e stacioneve turistike dhe pikës informative e logjistike, të përfshira në vlerën e mësipërme, do përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.	
9	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Krijimi i parkimeve publike të përshtatura edhe për autobuzë.</p> <p>Përcaktimi dhe vendosja e sinjalistikës në shtigjet drejt bjeshkëve dhe kullotave alpine (staneve), potenciale për zhvillimin e sporteve dimërore.</p> <p>Rinovimi i bujtinave në përshtatje me arkitekturën tradicionale.</p> <p>Pika promovimi dhe tregtimi të produkteve tradicionale gastronomike, etnografike dhe të artizanatit.</p> <p>Pika shitjeje guidash dhe produktesh në funksion të turizmit. Identifikimi i hapësirave të nevojshme për ngritjen e kampingjeve.</p> <p>Trajnimi i mikpritësve në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit turistik për lokalitetin.</p>	
10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Planet e Detajuara Vendore, sipas rastit.</p> <p>Synohet ruajtja e vlerave natyrore duke ofruar dhe shërbime akomoduese. Zona ka vlera të larta mjedisore dhe ndërhyrjet duhet të jenë të mirëorientuara në ruajtjen e tyre.</p> <p>Synohet shtimi i vendbanimeve ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave akomoduese në to, përpara shtrirjes në zona të reja.</p> <p>Synohen ndërhyrjet rikualifikuese në bujtinat ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave të reja akomoduese.</p> <p>Zona duhet të pajiset me infrastrukturë të përshtatshme për aktivitete duke sistemuar edhe ndriçimin urban, veçanërisht në Selcë. Në Tamarë projekti i rikualifikimit urban duhet të shtrihet dhe në pjesën tjetër të qendrës.</p>	



Lokalitetet e nivelit 2 - Tamarë-Selcë

10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Riaktivizimi i zonave ushtarake në shërbim të turizmit dhe komunitetit.</p> <p>Përparësi kanë rikonstruktionet dhe konvertimet e objekteve ekzistuese në bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, pika tregtimi, bare, restorante, etj. Rinovimi dhe përmirësimi i standardeve dhe rritja e efikasitetit energjetike janë prioritet.</p> <p>Në bujtina lejohen vendosja e çadrave dhe rulotëve brenda pronësisë së bujtinës.</p> <p>Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra, strehime alpine, si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale. Përparësi kanë konvertimet e staneve në struktura akomoduese (rinovim, prishje dhe rindërtim).</p>
----	-------------------------------	--

Neni 34
Lokalitetet e nivelit 2 - Razëm

1	Fshatra ⁸	Vrith, Razëm (Vrith), Bzhetë-Markaj, Vuç-Kurtaj.
2	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	Lokaliteti Razëm ndodhet brenda zonës së mbrojtur të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit. Zhvillimi i lokalitetit do të bazohet në Planin e Menaxhimit të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit, ku identifikohen nën-zonat: <ul style="list-style-type: none">• Zonë qendrore;• Zonë e shërbimeve të vizitorëve;• Zonë e përdorimit tradicional;• Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. Razma është ndër zonat me traditë të hershme në fushën turizmit malor ku gjenden pasuri të shumta natyrore dhe peizazhiste.
3	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none">• Turizmi malor dhe hapësirave natyrore• Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore• Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale• Turizmi argëtues dhe rekreativ• Turizmi i eventeve• Turizmi shëndetësor
4	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none">• Turizmi industrial dhe artizanal• Turizmi krijues• Turizmi i çiklizmit• Turizmi i speleologjisë• Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit
5	Shembuj aktiviteteve sipas turizmit kryesor	Shëtitje në natyrë dhe në shtigje panoramike (në këmbë, kuaj dhe mushkë), vizita në monumente të natyrës (gjeomonumente, ujëvara, kanione, pyje, lumenj, përrenj, shpella, korridore të gjelbra), piknikë, shëtitje me ski, ski nordike, ecje me raketa, slita etj. Vizita në ferma bujqësore, blegtorale dhe baxho, degustim i produkteve lokale, pjesëmarrje në aktivitetet e fermës, korrije dhe mbledhje e produkteve bujqësore lokale etj. Frekuentimi i bareve dhe restoranteve me ushqime dhe pije lokale, blerje e produkteve lokale, mësimi i proceseve të përpunimit dhe përgatitjes të specialiteteve lokale etj. Aktivitete të ndryshme rekreative si: shëtitje me biçikleta, mountain-bike, xhiro me balonë, mountain-board, kërcim me elastik, tenis, volejbol, futboll, basketboll, ping-pong, paint-ball, zip-line, gara orientimi, aktivitete dimërore si ski, slita, snow-kite, ecje me raketa etj. Pjesëmarrje në evente, festivale, panaire, ekspozita në fusha të ndryshme si: kultura, sporti, folklori, kinematografia, teatri, bujqësia etj.

⁸ Bazuar në Ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"



Lokalitetet e nivelit 2 - Razëm

6	Tipologjia e strukturave akomoduese	Bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks, hotele me kapacitet të ulët, qendër kurative, shtëpi ose banesa me qira, resorte.	
7	Kapaciteti akomodues	Aktual	Optimal
		Total: 355 shtretër Hotel: 317 shtretër Bujtina: 38 shtretër Kamping: 0 shtretër	Total: 700-750 shtretër Grupi 1: 150 shtretër Grupi 2: 400 shtretër Grupi 3: 200 shtretër
8	Parkimet e nevojshme për turistët	70-80 vende parkimi publik për turistët Parkimet e stacioneve turistike dhe pikës informative e logjistike, të përfshira në vlerën e mësipërme, do përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.	
9	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Krijimi i parkimeve publike të përshtatura edhe për autobuzë.</p> <p>Përcaktimi dhe vendosja e sinjalistikës në shtigjet drejt bjeshkëve dhe kullotave alpine (staneve), potenciale për zhvillimin e sporteve dimërore.</p> <p>Rinovimi i bujtinave në përshtatje me arkitekturën tradicionale.</p> <p>Pika promovimi dhe tregtimi të produkteve tradicionale gastronomike, etnografike dhe të artizanatit.</p> <p>Pika shitjeje guidash dhe produktesh në funksion të turizmit.</p> <p>Identifikimi i hapësirave të nevojshme për ngritjen e kampingjeve.</p> <p>Trajnimi i mikpritësve në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit turistik për lokalitetin</p>	
10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë plani i menaxhimit të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit</p> <p>Duhet të merren në konsideratë parashikimet e PPV Malësi e Madhe. Synohet ruajtja e vlerave natyrore duke ofruar dhe shërbime akomoduese.</p> <p>Synohet shtimi i vendbanimeve ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave akomoduese në to, përpara shtrirjes në zona të reja.</p> <p>Në zonë krahas strukturave akomoduese duhet të orientohet zhvillimi i strukturave të shërbimeve tregtare turistike dhe gastronomike.</p> <p>Përparësi kanë rikonstruktionet dhe konvertimet e objekteve ekzistuese në hotele, bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, pika tregtimi, bare, restorante, etj.</p>	

**Lokalitetet e nivelit 2 - Razëm**

10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Rinovimi e përmirësimi i standardeve dhe rritja e efikasitetit energjetik janë prioritet. Këto rikonstruksione duhet të jenë në përshtatje me arkitekturën tradicionale. Kthimi i staneve në struktura akomoduese (rinovim, prishje dhe rindërtim).</p> <p>Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra, struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale.</p>
----	-------------------------------	---



Neni 35
Lokaltetet e nivelit 2 - Reç

1	Fshatra ⁹	Reç, Qaf-Gradë, Rrepisht, Kokpapaj
2	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Lokalteti Reç ndodhet brenda zonë së mbrojtur të Parkun Natyror Bashkiak të Shkrelit.</p> <p>Zhvillimi i lokalitetit do të bazohet në Planin e Menaxhimit të Parkun Natyror Bashkiak të Shkrelit, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore • Zonë e shërbimeve të vizitorëve • Zonë e përdorimit tradicional • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm <p>Në lokalitet dhe në afërsi të tij gjenden monumente kulture dhe natyre.</p>
3	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi argëtues dhe rekreativ • Turizmi i eventeve
4	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi industrial dhe artizanal • Turizmi krijues • Turizmi malor dhe hapësirave natyrore • Turizmi i historisë dhe kulturës lokale • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi shëndetësor • Turizmi i biznesit ose profesional • Turizmi social dhe i solidaritetit
5	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	<p>Vizita në ferma bujqësore, blegtorale dhe baxho, degustim i produkteve lokale, pjesëmarrje në aktivitetet e fermës, korrije dhe mbledhje e produkteve bujqësore lokale etj.</p> <p>Frekuentimi i bareve dhe restoranteve me ushqime dhe pije lokale, blerje e produkteve lokale, mësimi i proceseve të përpunimit dhe përgatitjes të specialiteteve lokale etj.</p> <p>Aktivitete të ndryshëm rekreative si, shëtitje me biçikleta, mountain-bike, xhiro me balonë, kërcim me elastik, tenis, volejball, futboll, basketboll, ping-pong, paint-ball, zip-line, gara orientimi etj.</p> <p>Pjesëmarrje në evente, festivale, panaire, ekspozita në fusha të ndryshme si: kultura, sporti, folklori, kinematografia, teatri, bujqësia etj.</p>
6	Tipologjia e strukturave akomoduese	Bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks, hotele me kapacitet të ulët, qendër kurative, shtëpi ose banesa me qira, resorte.

⁹ Bazuar në Ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"



Lokalitetet e nivelit 2 - Reç

7	Kapaciteti akomodues	Aktual	Optimal
		Total: 27 shtretër Hotel: 12 shtretër Bujtina: 15 shtretër Kamping: 0 shtretër	Total: 200-250 shtretër Grupi 1: 50 shtretër Grupi 2: 120 shtretër Grupi 3: 80 shtretër
8	Parkimet e nevojshme për turistët	20-30 vende parkimi publik për turistët Parkimet e stacioneve turistik dhe pikës informative e logjistike, të papërfshira në vlerën e mësipërme, do përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura	
9	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Krijimi i parkimeve publike të përshtatura edhe për autobuzë.</p> <p>Përcaktimi dhe vendosja e sinjalistikës në shtigjet drejt zonave me vlera natyrore dhe kulturore: lugina e Rrjollit, Repisht etj.</p> <p>Rinovimi i bujtinave në përshtatje me arkitekturën tradicionale.</p> <p>Pika promovimi dhe tregtimi të produkteve tradicionale gastronomike, etnografike dhe të artizanatit.</p> <p>Promovim i pyllit të gështenjave dhe tregtimi i tyre si produkt lokal</p> <p>Pika shitjeje guidash dhe produktesh në funksion të turizmit. Identifikimi i hapësirave të nevojshme për ngritjen e kampingjeve.</p> <p>Trajnimi i mikpritësve në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit turistik për lokalitetin.</p>	
10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë plani i menaxhimit të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit.</p> <p>Një nga specifikat e këtij lokaliteti është orientimi drejt zhvillimit të pemëtarisë e njohur më shumë për gështenjat. Ndërthurja e këtij aktiviteti me zonat natyrore e bëjnë zonën tërheqëse duke nxitur turizmin.</p> <p>Synohet ruajtja e vlerave natyrore duke ofruar dhe shërbime akomoduese. Zona ka vlera të larta mjedisore dhe ndërhyrjet duhet të jenë të mirëorientuara në ruajtjen e tyre.</p> <p>Synohet shtimi i vendbanimeve ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave akomoduese në to, përpara shtrirjes në zona të reja.</p> <p>Në zonë krahas strukturave akomoduese duhet të orientohet zhvillimi i strukturave të shërbimeve tregtare turistike dhe gastronomike.</p>	



Lokalitetet e nivelit 2 - Reç

10	Kushte specifike për zhvillim	<p>Përparësi kanë rikonstrukcionet dhe konvertimet e objekteve ekzistuese në hotele, bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, pika tregtimi, bare, restorante, etj. Rinovimi, përmirësimi i standardeve dhe rritja e efikasitetit energjetik janë prioritet. Në bujtina lejohen vendosja e çadrave dhe rulotëve brenda pronësisë së bujtinës.</p> <p>Përparësi i duhet dhënë përmirësimin të lidhjes infrastrukturore të fshatrave dhe qendrave të tyre.</p> <p>Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale.</p> <p>Në këto zona lejohen promovimet e vlerave natyrore dhe kulturore si dhe festa tradicionale apo evente me fokus turizmin.</p>
----	-------------------------------	--

Neni 36
Lokalitetet e nivelit 2 - Bogë

1	Fshatra ¹⁰	Bogë
2	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Lokaliteti Bogë ndodhet brenda zonë së mbrojtur të Parkut Kombëtar të Alpeve.</p> <p>Zhvillimi i lokalitetit do të bazohet në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none">• Zonë qendrore;• Zonë e menaxhimit efektiv;• Zonë e përdorimit tradicional;• Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. <p>Në lokalitet gjenden pasuri natyrore, peizazhistike si dhe gjurmë arkeologjike të vendbanimeve të hershme.</p>
3	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none">• Turizmi malor dhe hapësirave natyrore• Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore• Turizmi argëtues dhe rekreativ• Turizmi i speleologjisë
